

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr.8664, datë 18.9.2000

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7874, DATË 17.11.1994 "PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8526, DATË 23.9.1999

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7874, datë 17.11.1994 "Për Statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", ndryshuar me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në shkronjën "d" të nenit 3 shtohet paragrafi i mëposhtëm:

"Të tilla vlerësohen edhe dokumentet e lëshuara nga arkivat shtetërore të rretheve dhe të institucioneve shtetërore, në bazë të të dhënave të dosjeve personale që kanë në ruajtje."

Neni 2

Në nenin 3 pas shkronjës "e" shtohen paragrafët e mëposhtëm:

"Kur mungojnë dokumentet e kërkuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d", pjesëmarrja në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe qenia veteran i saj mund të vërtetohen me vendimin e Komisionit Qendror të Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Për të vërtetuar pjesëmarrjen e organizuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare mund të shqyrtojë dhe të vlerësojë dokumente të bazuara në historikun e fshatit, të qytetit ose të formacionit partizan, të miratuar nga komisionet e posaçme të ngritura para vitit 1994, të lëshuara nga muzeu historik i rrethit ose nga organi drejtues i Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në shkallë rrethi e lart, në të dhënat historiografike ose të medias së shkruar të botuara para datës 31 dhjetor 1993, në dokumentet personale si librezë ushtarake, librezë të punës, certifikatë anëtarësie në një organizatë politiko-shoqërore, në "dëshminë e partizanit", në të dhënat arkivore zyrtare, në dëshmitë personale nga bashkëluftëtarët, bashkëpunëtorët ose bashkëvuajtësit e kohës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Namik Dokle